

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Vendimet skandaloze - Pagesat për koncesionet arrijnë në 1 miliard euro, 440 milionë shkuan për kontratat nën hetim
ADRESA	https://www.syri.net/politike/919427/pagesat-per-koncesionet-arrijne-ne-1-miliard-euro-440-milione-shkuan-per-kontratat-nen-hetim/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	27 shtator 2026, 07:30:46 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	27 shtator 2026, 06:27:52 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	6cef9e9e21aa36ebdd98e6a92da5787d08075fd53ef69e2904d9093502fabdaa
TEKSTI	51e1d5ff809731b9909dcb87a93bdaea6b6776f5e3c3fb2fc89a6a7655026fda
PAMJA	209bd3e72762b7efae259deb98f0e589636d75a70e50bdeed5eb112d8ec1c2ff

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	b7fb91108a881acc339698a004c77289a208eaf39f02243298f9fabcf3f888f
E MËPARSHMJA	—
RRËNJJA MERKLE	f3fa3671555d7ae6cb03bad74ec6398ad3819e03f2270ea6128c9f6d225eb63a8
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/b7fb91108a881acc339698a004c77289a208eaf39f02243298f9fabcf3f888f>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

**FATMIR MEDIU**

Rama heshti për Kosovën në OKB, nuk iu kundërvu Vuçiçit dhe zgjodhi të flasë për Diellën

**NDRIÇIM KULLA**

Dorëheqja e Ramës, kërkesë edhe e ndërkombëtarëve



Pagesat për koncesionet arrijnë në 1 miliard euro, 440 milionë shkuan për kontratat nën hetim

08:27, 27/09/2026

ZMADHO TEKSTIN



Për periudhën 2017-2025 buxheti i shtetit ka paguar në total 98 miliardë lekë, ose rreth 1 miliard euro, për 12 kontrata koncesionare: Rruga e Arbrit, skanimit, sterilizimi, laboratorët, Inceneratori i Tiranës, check-up, dializa, mirëmbajtja e rrugës Milot-Morinë, infrastruktura arsimore, Inceneratori i Fierit, rruga Orikum-Dukat dhe Inceneratori i Elbasanit. Sot, gati gjysma e kësaj shumë është nën hetim, ndërsa nuk ka përgjegjës për arkitektët e këtij abuzimi masiv! Teksa shumë nga këto koncesione po shkojnë drejt fundit nuk ka asnjë analizë se çfarë i sollën ekonomisë (përveç abuzimeve, ndoshta) dhe sa eficiente ishte (sh)përdorimi i parave të taksapaguesve në të ashtuquajturat skemat të partneritetit publik privat.

Pas vitit 2015, qeveria e zgjeroi me shpejtësi praktikën e dhënies me koncesion të një sërë shërbimesh dhe projektsh publike, sipas modelit të Partneritetit Publik-Privat (PPP).

Në ndryshim nga koncesionet e mëparshme, kur jepej në përdorim shërbimi, apo pasuria natyrore dhe shoqëritë i gjeneronin të ardhurat nga aktiviteti apo tarifrat, përmes PPP-ve shteti merrte përsipër të paguante çdo vit nga buxheti.

Kjo politikë vijoi pavarësisht kundërshtimeve të hershme të institucioneve financiare ndërkombëtare, të cilat kërkonin që çdo kontratë të paraprihej nga një analizë e qartë e kostove dhe përfitimeve.

Në vitin 2015 u dhanë koncesioni i sterilizimit dhe ai i kontrollit shëndetësor bazë, i njohur si "check-up". Në vitin 2016 u miratua koncesioni i dializës, ndërsa në vitin 2019 ai i laboratorëve, të gjitha kontratat në sektorin e shëndetësisë.

Në të njëjtën periudhë nisi edhe praktika e koncesioneve për trajtimin e mbetjeve. Kontrata për inceneratorin e Elbasanit u dha në vitin 2015, më pas u shtua ajo e Fierit në vitin 2017 dhe, në vitin 2019, koncesioni i Tiranës.

më të lexuarat

'Iu hoq cipa e maskës mazhorancës', Goxhaj: Po i vjen fundi kësaj kaste, Rama s' menaxhon dot më

VIDEO/ Balliu: A ka folur Edi Rama me Ergys Agasin përmes telefonit të Vlora Hysenit?

Berisha: Vlora Hyseni është kthyer për t'u dhënë restin bashkëpunëtorëve të vet që e tradhtuan

'Garancia e plotë' e Ramës dhe përgjegjësia e tij politike për Vlora Hysenin

Fjalimi i turpshëm në OKB/ Berisha: Rama, armik i egër i Kosovës, tani po përhap shpifje të ulëta kundër VV-së

'Zullumi po e kap për fyti Ramën', Noka në Tepelenë: Skandalet e kanë zhveshur totalisht

Në vitin 2017 u dha me koncesion mirëmbajtja e rrugës Milot–Morinë, ndërsa në vitin 2018 u miratua kontrata për Rrugën e Arbrit. U rishikua gjithashtu koncesioni i skanimit, i miratuar në vitin 2013 nga qeveria e atëhershme në ikje. Me synimin për të lehtësuar barrën financiare mbi bizneset, qeveria mori përsipër të paguante përmes buxhetit një pjesë të kostos së shërbimit.

Të gjitha këto kontrata përfituan pagesa të drejtpërdrejta nga buxheti i shtetit. Rritja e detyrimeve financiare nga koncesionet e detyroi qeverinë, pas presionit të Fondit Monetar Ndërkombëtar, të vendoste një rregull fiskal për kufizimin e tyre.

Sipas këtij rregulli, shuma totale e pagesave vjetore neto të kryera nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme, që burojnë nga kontratat koncesionare ose Partneritetet Publike-Private, nuk duhet të tejkalojë 5% të të ardhurave tatimore faktike të vitit të mëparshëm buxhetor.

Në rast të tejkalimit të këtij niveli, Këshilli i Ministrave duhet të marrë masa korrektuese në krahun e të ardhurave buxhetore, të nevojshme dhe të mjaftueshme për rikthimin brenda kufirit të lejuar gjatë dy viteve të ardhshme buxhetore.


Ky kufi nuk është tejkaluar deri tani, teksa të ardhurat tatimore janë rritur dhe numri i kontratave me pagesa direkte nga buxheti nuk është zgjeruar më tej, pas presionit të lartë ndërkombëtar. Në vitin 2025, pagesat për kontratat koncesionare përbëjnë vetëm 2% të të ardhurave tatimore faktike të vitit 2024, nga 2.22% një vit më parë.

Megjithatë, niveli i ulët në raport me kufirin fiskal nuk dëshmon domosdoshmërisht eficiencën e këtyre shpenzimeve. Realiteti ka treguar se një pjesë e konsiderueshme e kontratave ka rezultuar joeficiente në kosto, ndërsa disa prej tyre janë tashmë objekt hetimi zyrtar nga SPAK, Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.

Të dhënat e Ministrisë së Financave për buxhetet faktike të periudhës 2017-2025, të përpunuara nga "Monitor", tregojnë se buxheti i shtetit ka paguar në total 98 miliardë lekë, ose rreth 1 miliard euro, për 12 kontrata koncesionare:

Rruga e Arbrit, skanimi, sterilizimi, laboratorët, Inceneratori i Tiranës, check-up, dializa, mirëmbajtja e rrugës Milot–Morinë, infrastruktura arsimore, Inceneratori i Fierit, rruga Orikum–Dukat dhe Inceneratori i Elbasanit.

Pagesa më e lartë është kryer për Rrugën e Arbrit, me 22.6 miliardë lekë. Më pas renditet koncesioni i sterilizimit, me 14.8 miliardë lekë, skanimi me 13.7 miliardë lekë dhe Inceneratori i Tiranës me 8.4 miliardë lekë. (Shiko tabelën e plotë: Pagesat faktike nga buxheti i shtetit për koncesionet, 2017-2025).



Nga 12 koncesionet e financuara nga buxheti, për gjashtë prej tyre – tre inceneratorët, check-up, sterilizimin dhe laboratorët – është hapur një hetim zyrtar ose kanë nisur procedurat nga SPAK-u, me akuza që përfshijnë korrupsionin, shpërdorimin e detyrës dhe pastrimin e parave.

Për këto gjashtë kontrata, buxheti i shtetit ka paguar gjatë periudhës 2017-2025 gjithsej 44.4 miliardë lekë, ose rreth 460 milionë euro. Kjo shumë përbën 44% të të gjitha pagesave të kryera nga buxheti për koncesionet.

Nga totali, gati 15 miliardë lekë janë paguar për projektet e inceneratorëve. Më shumë se gjysma e kësaj shume ka shkuar për koncesionin e Tiranës.

Ndërkohë, rreth 29.6 miliardë lekë janë paguar për tre koncesionet e shëndetësisë që janë nën hetim ose procedura nga SPAK-u. Gjysma e pagesave për këto koncesione ka shkuar vetëm për sterilizimin.

Edhe vetë Financat kanë shprehur shqetësimin se kontratat koncesionare nuk po kontrollohen dhe as monitorohen në respekt të detyrimeve ligjore dhe marrëveshjeve ndërmjet shtetit dhe privatit, që janë instrumente të detyrueshme.

Së fundmi, Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit ka publikuar projektin "Për miratimin e rregullave për përmbajtjen dhe formën e regjistrimit elektronik të

Berisha: Rama kërkon t'i paraqesë shqiptarët si antisemitë, terroristë e çdo gjë tjetër vetëm që të qëndrojë në pushtet


Berisha: Sulmi i Ramës ndaj Joe Biden për dënimin e Thaçit është një paturpësi ekstreme

'Qeveria braktisi qytetarët përballë çmimeve', aktivisti: Shqipëria mban TVSH-në 20% për shportën bazë

koncesioneve dhe Partneritet Publik-Privat, i cili synon të krijojë një bazë të unifikuar të dhënash për monitorimin dhe vlerësimin e ndikimit të koncesioneve në ekonomi.

Sipas relacionit që shoqëron projektvendimin, aktualisht informacioni mbi kontratat e koncesioneve dhe PPP-ve administrohet në mënyrë të fragmentuar nga autoritetet kontraktuese, pa ekzistuar një sistem i vetëm kombëtar që garanton standardizimin e informacionit, përditësimin periodik të të dhënave dhe monitorimin në kohë reale të kontratave.

Kjo situatë krijon vështirësi në monitorimin institucional të kontratave, në analizimin e angazhimeve financiare të shtetit, në evidentimin e ndryshimeve kontraktore, si dhe në përgatitjen e raporteve për organet mbikëqyrëse dhe auditimin.



Aktivitetin e koncesioneve po e merr gradualisht shteti

Partneritetet Publike-Private (PPP), në formën e koncesioneve, një nga modelet që tërhoqën shumë sipërmarrje, për shkak të biznesit të sigurt dhe normës së lartë të fitimit, po dalin gradualisht nga lista e më të mëdhave pas përfundimit të kontratave.

Pjesën më të madhe të tyre po e merr sërish shteti, teksa realiteti po tregon se ato nuk sollën ndonjë vlerë të shtuar, apo përfitime në kosto për publikun.

Kontrata e koncesionit ndërmjet Ministrisë së Financave, si autoritet kontraktues, dhe shoqërive "Sicpa Security Solutions S.A." e "Sicpa Security Solutions Albania sh.p.k.", për projektimin, financimin, dizejnimin, prodhimin dhe ngritjen e një sistemi për emetimin, shpërndarjen, gjetjen dhe monitorimin e pullave fiskale e të pullave të kontrollit të barnave përfundoi në datën 31 dhjetor 2024, pasi ishte zgjatur edhe me dy vjet në janar 2023. Nga janari 2025, prodhimi dhe shpërndarja e pullave kryhet nga Shtypshkronja e Letrave me Vlerë.

Një tjetër koncesion që ka përfunduar është ai i markimit të karburanteve që po zbatohej nga "GFI Albania". Kontrata 10-vjeçare përfundonte më 1 gusht 2023, ndërsa qeveria vendosi ta shtyjë edhe me një vit. Në vitin 2024, i fundit i aktivitetit, shoqëria raportoi të ardhura prej 296 milionë lekësh, me tkurrje 37% me bazë vjetore.

Më 31 korrik 2023 përfundoi dhe kontrata me "Aleat", që kishte me koncesion prodhimin e dokumenteve të qytetarëve shqiptarë. Pas përfundimit të periudhës së koncesionit, shoqëria i ka kaluar Autoritetit zotërimin e vendndodhjeve të koncesionit, mjediset e koncesionit dhe të gjitha asetet e projektuara dhe të përdorura gjatë periudhës së koncesionit.

Kompania shtetërore, që e kryen tashmë këtë shërbim "Identitek", ka hyrë prej dy vitesh në listën e "Monitor 200". Në vitin 2025 raportoi të ardhura prej 3.5 miliardë lekësh, me rënie 3.8% me bazë vjetore.

"S2 Albania", e cila zbaton marrëveshjen e koncesionit të skanimit, në vitin 2025, raportoi të ardhura prej 1.44 miliardë lekësh, në të njëjtin nivel me vitet e mëparshme.

Koncesionet e formës PPP, pagesat arritën rekord në 2025-n, katër koncesione përfundojnë këtë vit


Pas vitit 2018, qeveria ndoqi strategjinë e projekteve të Partneritetit Publik – Privat, ku kompania private angazhohet të kryejë një shërbim, përkundrejt pagesave vjetore nga buxheti i shtetit.

Sipas Ministrisë së Financave, në vitin 2025 rezultojnë 10 kontrata koncesionare/PPP me mbështetje buxhetore. Pagesat faktike për vitin 2025, në total arritën në 13.35 miliardë lekë, me rritje minimale vjetore prej 0.5%, duke shënuar nivelin më të lartë historik që prej vitit 2017, kur ka filluar raportimi.

Sipas tabelës së Ministrisë së Financave, katër koncesione parashikohet të përfundojnë në vitin 2026, nga të cilat tre janë të sektorit të shëndetësisë, sterilizimi, kontrolli mjekësor (check up) dhe dializa. Koncesioni i katërt është ai

për infrastrukturën arsimore në Tiranë.

Për të katërta koncesionet, pagesat në vitin 2025 ishin 4.4 miliardë lekë, ose 33% e pagesave totale.



"Albanian Highway Concession" ka fituar koncesionin për ndërtimin, operimin dhe mirëmbajtjen e Rrugës Milot–Morinë, me afat 30 vjet, e miratuar në vitin 2016, por zbatimi i saj nisi vetëm në shtator të vitit 2018. Ajo është një konsorcium mes dy sipërmarrjeve të mëdha, "Kastrati" dhe "Salillari" (me nga 50% secila).

Kompania raportoi të ardhura prej 1.9 miliardë lekësh në vitin 2025, me tkurrje të fortë prej gati 39%, duke qenë një tjetër dalje e koncesioneve nga lista e "Monitor 200".

Të ardhurat e arkëtuara nga tarifa e përdorimit të rrugës në vitin 2025 janë 1.85 miliardë lekë, me rritje 12% me bazë vjetore.

Trafiku i rrugës Durrës-Kukës po rezulton më i lartë se parashikimet fillestare. Sipas raportit të aktivitetit, në kontratën e koncesionit është parashikuar që, në rast se shuma e të ardhurave nga tarifa e përdorimit të rrugës tejkalon kufirin e parashikuar në kontratë, 60% e këtij tejkalimi do t'i kthehet autoritetit kontraktues.

Shuma e përlogaritur për vitin ushtrimor, në bazë të kësaj kërkesë të kontratës, është rreth 338 milionë lekë, nga 277 milionë lekë vitin e mëparshëm.

Sipas raportit vjetor, shoqëria ka 48 punonjës të shërbimit të mbledhjes së tarifës, 22 punonjës teknikë dhe operatorë të shërbimeve të mirëmbajtjes dhe të operimit të autostradës, si dhe 12 punonjës të tjerë administrate.

"SaniService" fitoi në vitin 2015 koncesionin për "ofrimin e shërbimeve të integruara për setin e personalizuar të instrumenteve kirurgjikale, furnizimin me material mjekësor steril njëpërdorimësh në sallat kirurgjikale, si dhe trajtimin e mbetjeve biologjike dhe dezinfektimin e sallave kirurgjikale", me afat 10-vjeçar. Kompania deklaroi të ardhura prej 1.56 miliardë lekësh në vitin 2025, pothuajse njëlloj me vitin e mëparshëm, duke mos hyrë në renditjen e "Monitor 200".

Për këtë koncesion kanë nisur hetimet nga Prokuroria e Posaçme, SPAK, pas kallëzimeve se ky projekt është i panevojshëm, duke hedhur dyshime për abuzime të ndryshme financiare.

Sipas tabelës së koncesioneve të Ministrisë së Financave, ky koncesion përfundon në vitin 2026. Në maj 2026, sipas të dhënave të ekstraktit, kompania ka mbyllur adresat në mbi 30 njësi.

Që nga fillimi i aktivitetit, në vitin 2015 deri në 2025, shoqëria ka marrë gjithsej nga buxheti i shtetit 13.8 miliardë lekë, duke qenë deri tani koncesioni i dytë më i madh i formës PPP, pas Rrugës së Arbrit.

Kjo shumë është gati 40% më e lartë se kontrata fillestare e koncesionit të sterilizimit që ishte përlogaritur në 10 miliardë lekë, por kostot e pritshme u rishikuan më pas ndjeshëm në rritje, për shkak të numrit më të lartë të ndërhyrjeve kirurgjikale dhe pagesës sipas shërbimit.

Shërbimi tashmë i ka kaluar shtetit. Në janar 2026, qeveria krijoi një shoqëri aksionare me kapital 100 për qind shtetëror "Operatori i shërbimeve të integruara të sterilizimit" SH.A. për ofrimin e shërbimeve të integruara të sterilizimit në të gjitha spitalet publike të vendit.

Shoqëria e re shtetërore do të marrë përsipër të gjithë zinxhirin e shërbimeve të sterilizimit, nga furnizimi me instrumente kirurgjikale sterile dhe materiale njëpërdorimëshe, deri te menaxhimi i Stacionit Qendror të Sterilizimit në QSUT, trajtimi i mbetjeve spitalore me rrezik biologjik dhe digjitalizimi i procesit.

Të gjitha tarifat e këtyre shërbimeve do të arkëtohen nga vetë shoqëria, e cila do të financohet nga të ardhurat e saj dhe burime të tjera të ligjshme, duke ruajtur formalisht karakterin e shërbimit publik.

Koncesionari tjetër në shëndetësi, "3P Life Logistic", raportoi të ardhura prej 731

milione lekesh, ne te njejtin nivel me nje vit me pare, sipas pagesave nga Ministria e Financave (kompania nuk e ka dorëzuar ende bilancin).

Aktiviteti kryesor i biznesit të shoqërisë përfshin paketën e shërbimit të kontrollit mjekësor për moshat 40 – 65 vjeç, për një periudhë prej 10 vjetësh, siç parashikohet në marrëveshjen e koncesionit nënshkruar ndërmjet "3P Life Logistic" sh.p.k. dhe Ministrisë së Shëndetësisë, më 7 janar 2015. Edhe për këtë koncesion, kanë nisur hetimet nga SPAK-u.

Edhe ky koncesion përfundon në fund të vitit 2026. Kontrata e Check-Up u pezullua nga marsi 2020 deri në shtator 2021 për rreth 17 muaj, si rrjedhojë e masave kufizuese në lëvizje për parandalimin e virusit.

Afati i pezullimit shkoi si shtyrje automatike që i lejon kompanisë ofrimin e shërbimit edhe për dy vite të tjera nga viti 2025.

Që nga fillimi i aktivitetit në vitin 2025, koncesioni ka marrë 6.7 miliardë lekë
nënshkruar nga kompania dhe është i shtetit

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.